

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEKNOLOGIJE MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARCHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org. Jedinica Org Unit	013
Nr. faqeve Br. stranica No. pages	2
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	2314
Data: Datum: Date:	01, 07, 2015
Prishtinë / a	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Prishtinë, më 1 korrik 2015

Ref. nr: 272/018

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të neneve 92 dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenet 4, 21, 22 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, 21 tetor 2010), nenin 8, paragrafi 1.4 dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (Gazeta Zyrtare, Nr. 1, 18 prill 2011), nenin 2, paragrafi 1.5, të Rregullores nr. 06/2012 për Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenin 30, paragrafi 4, të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare nr. 72/25 qershor 2010), nxjerr këtë:

V E N D I M

për emërimin e ushtruesit të detyrës të drejtorit të AKA


1. Furtuna Mehmeti emërohet ushtrues detyre i drejtorit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA).
2. Furtuna Mehmeti emërohet ushtrues detyre për periudhën prej tre (3) muaj, nga 1 korrik 2015 deri më 1 tetor 2015.
3. Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Duke u mbështetur në dispozitat e lartcekura dhe për shkak se drejtori i AKA-së është pezulluar përkohësisht nga puna deri në përfundimin e procedurave gjyqësore ndaj tij (Vendimi nr. 197/01B, 12 dhjetor 2014), me qëllim të zëvendësimit të pozitës përkatëse, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prof. dr. Arsim BAJRAMI

Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë



Vendimi ju dërgohet:

1. Furtuna Mehmeti;
2. Agjencisë së Kosovës për Akreditim;
3. Sekretarit të Përgjithshëm, MASHT;
4. Arkivit të MASHT.